

# Rekomandim i Konventës së Feve të të dy Kantoneve Basel për temën e diskriminimit në komunitete fetare dhe përmes tyre

Me pranimin e normativës penale të zgjeruar anti-raciste kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual<sup>1</sup> (neni 261<sup>bis</sup> StGB [Kodi Penal] dhe neni 171c MStG [Kodi Penal Ushtarak]) ngrihen pyetje të reja në lidhje me pasazhe të veçanta në tekste fetare.

Ky rekomandim i Konventës së feve të të dy Kantoneve Basel (RTRel)<sup>2</sup> i drejtohet personelit fetar kujdestar dhe drejtues<sup>3</sup> dhe synon të shërbejë si ndihmë për citimin e pasazheve nga tekstet fetare me përmbajtje (të mundshme) diskriminuese, me qëllim që të shmanget konsumimi faktik i një vepre penale brenda normativës penale të racizmit.

Duhet theksuar, që hetimi për konsumimin faktik të një vepre penale shqyrtohet dhe hetohet gjithmonë sipas rastit të veçantë. Veç kësaj, juridiksioni për normativën penale të zgjeruar anti-raciste ndodhet ende në fillim fare.

Prandaj ky rekomandim **nuk mund të jetë një udhëzim për të vepruar**, por vetëm mund të ofrojë **përkrahje**. Ai jep udhëzime të përgjithshme rreth veprimeve të dënueshme, shpreh një rekomandim në lidhje me citime fetare dhe kësisoj ka një efekt parandalues.

## Veprime të dënueshme

Veprime të dënueshme kundër në personi ose një grupi personash për shkak të «racës, kombësisë, fesë apo orientimit seksual» të tyre në kuptimin e nenit 261<sup>bis</sup> StGB janë:

- Thirrje publike për urrejtje ose diskriminim (par. 1)
- Shpërndarje publike e ideologjive diskriminuese (par. 2)
- Organizim dhe nxitje të aktiviteteve propagandiste ose pjesëmarrja në to (par. 3)
- Diskriminim publik përmes fjalës, shkrimit, gjesteve, veprimeve ose në ndonjë mënyrë tjetër (par. 4)

1 Me zgjerimin e normativës penale mbrohen tanimë edhe personat, që diskriminohen për shkak të homoseksualitetit, heteroseksualitetit ose biseksualitetit të tyre.

2 Sipas parimeve themelore të datës 10 dhjetor 2018, RTRel-ja mund të debatohet për ligje dhe dispozita si dhe për zbatimin e tyre në nivel federal dhe kantonal, «përderisa dhe po qe, që ato ndikojnë në komunitete fetare ose në ushtrimin e veprimeve fetare apo në udhëzime për veprime të tilla».

3 Anëtarë të personelit fetar kujdestar dhe drejtues janë: predikueset dhe predikuesit si dhe të gjithë persona të tjerë, që kanë influencë mbi komunitetet fetare.

- Mohim, minimizim i rëndë ose justifikim i gjenocidit ose i krimeve të tjera kundër njerëzimit (par. 4)
- Refuzim i një shërbimi, që u është dedikuar të gjithëve (par. 5)

## Parakushtet për dënueshmëri

Këto kushte ndikojnë, që një shprehje diskriminuese është e dënueshme:

### 1. Cenimi i dinjitetit njerëzor

Sjellja diskriminuese vetëm atëherë është e dënueshme, nëse e **cenon dinjitetin njerëzor**. Për një rast të tillë bëhet fjalë, nëse persona ose grupe personash për shkak të përkatësisë së tyre quhen ose trajtohen si të pavlerë.

### 2. Publiku

Sjellja ose shprehjet diskriminuese duhet të ndodhen **publikisht**. Kjo do të thotë para një rrethi më të madh personash, midis të cilëve nuk ekziston një marrëdhënie personale. Pra jo në rrethin familjar ose shoqëror apo në ndonjë mjedis tjetër të ngushtë me marrëdhënie personale ose një besim të posaçëm midis personave.

### 3. Paramendim

Sjellja diskriminuese vetëm atëherë është e dënueshme, nëse dikush vepron **me paramendim**. Kjo do të thotë, që autori/autorja është i/e vetëdijshëm/vetëdijshme, që sjellja përçmon/denigron dikë, dhe prapëseprapë apo qëllimisht për këtë arsye e bën.

→ Nëse **të gjitha këto kushte** janë të plotësuara, një shprehje përmbush gjendjen faktike të veprës penale sipas nenit 261<sup>bis</sup> StGB dhe kështu mund të ketë pasoja penale: **Dënim me heqje lirie deri në 3 vjet ose dënim me gjobë**. Megjithatë çdo rast shqyrtohet gjithmonë në veçanti.

## Rekomandim sesi të merremi me citimin e pasazheve nga tekstet fetare me përmbajtje diskriminuese

Edhe citimi i pasazheve nga tekstet fetare me përmbajtje diskriminuese<sup>4</sup> mund të vlerësohet si një shprehje e dënueshme, nëse

1. përmbajtja drejtohet kundër personave ose grupeve për shkak të «racës, kombësisë, fesë ose orientimit seksual» të tyre (= cenimi i dinjitetit njerëzor)
2. citimi bëhet në ceremonitë fetare (= publiku)
3. citimi përdoret nga personi drejtues si thirrje për një qëndrim diskriminues ose madje të urrejtjes ndaj këtyre personave (= paramendim)

<sup>4</sup> Tri shembuj të rastësishëm për këtë problematikë nga Bibla: Ligji i Përtërirë 7,16: «Do të shfarosesh, pra, të gjithë popujt, që Zoti, Perëndia yt, po të jep në pushtetin tënd...»; Psalmi 139, 19: «Me siguri, ti do vrasësh të pabesin, o Perëndi»; Levitiku 20, 13: «Në qoftë se dikush ka marrëdhënie seksuale me një burrë ashtu si ato, që bëhen me një grua, që të dy kanë kryer një degjenerim të neveritshëm, do të dënohen pa tjetër me vdekje...»

Për këtë arsye, RTRel-ja u rekomandon anëtarëve të personelit kujdestar ose drejtues, që pasazhet e teksteve me përmbajtjet, të cilat për shkak të cilësive të veçanta («raca, kombësia, feja ose orientimi seksual») drejtohen kundër një grupi personash **të posaçëm, të mos i citojnë pa komentim në kuptimin e ligjit** në shërbesa, në namazin e xhumasë ose në meditime para komunitetit fetar.

Një citim pa komentim mund të kuptohet nga komuniteti fetar si një thirrje për një veprim përkatës ose për urrejtje ndaj këtij grupi personash. Sepse pa komentim nga ana e drejtuesit fetar një citim mund të kuptohet nga komuniteti fetar si vullneti i perëndisë ose i autoritetit përkatës më të lartë fetar dhe mund të ndikojë në formimin e qëndrimeve përkatëse ose në kryerjen e veprimeve përkatëse. Kështu mund të ketë pasojë penale për anëtarin e personelit fetar drejtues.

→ **Me rëndësi:** Mendime fetare edhe në vazhdim mund të dhe lejohen të shprehen dhe botëkuptime të ndryshme mbi vlerat mund të jenë temë, përderisa ato nuk e cenojnë dinjitetin njerëzor të të tjerëve.

### **Qëndrimi i RTRel-së në çështje diskriminimi**

EKonventa është e vetëdijshme, që ekzistojnë forma të tjera diskriminimi (ndër të tjera të përcaktuara nga Kushtetuta Federale e Zvicrës neni 8 par. 2 Kushtetuta Federale)<sup>5</sup>, të cilat nganjëherë gjinden gjithashtu nëpër komunitete fetare. Posaçërisht diskriminimi për shkak të gjinisë është një temë, e cila debatohet herë pas here edhe në RTRel-në dhe që rregullohet në nenet kantonale rreth barazisë së gjinive si dhe në Kushtetutën Federale (neni 8 par. 3 Kushtetuta Federale)<sup>6</sup>. Megjithëse që këtu bëhet fjalë për një temë me parakushte të tjera ligjore, RTRel-ja ia rezervon vetes të drejtën të mos e shqyrtojë këtë temë këtu.

RTRel-ja angazhohet për një bashkëjetesë të mirë, e cila nuk ka nevojë për asnjë diskriminim të të tjerëve dhe që respekton botëkuptimet e tjera fetare. Një bashkëjetesë, e cila megjithatë e reflekton diskriminim, i cili gjithmonë është pjesë e historisë së vet fetare.

5 «Nuk lejohet diskriminimi i askujt, shprehimisht jo për shkak të origjinës, të racës, të gjinisë, të moshës, të gjuhës, të pozitës sociale, të formës së jetesës, të bindjes fetare, botëkuptimore ose politike apo për shkak të një aftësie të kufizuar fizike, mendore ose psikike.» (neni 8 par. 2 Kushtetuta Federale)

6 «Burri dhe gruaja janë të barabartë. Ligji kujdeset për barazinë e tyre ligjore dhe faktike, para së gjithash në familje, arsimim dhe punë. Burri dhe gruaja kanë pretendimin për pagën e njëjtë për punën me të njëjtën vlerë.» (neni 8 par. 3 Kushtetuta Federale)

### **Shtojca: Nenet ligjore**

Diskriminim për shkak të «racës, kombësisë, fesë ose orientimit seksual»  
Neni 261<sup>bis</sup> diskriminim race i StGB-së<sup>7</sup> cakton:

«Kush bën thirrje publike për urrejtje ose diskriminim kundër një personi ose kundër një grupi personash për shkak të racës, kombësisë ose fesë ose orientimit seksual të tyre, kush publikisht përhap ideologji, të cilat synojnë për denigrimin sistematik ose për shpifjen e këtyre personave ose të këtyre grupeve, kush me po atë synim organizon ose nxit aktivitete propagandiste apo merr pjesë në të tilla, kush publikisht përmes fjalës, shkrimit, gjesteve, veprimeve ose në ndonjë mënyrë tjetër denigron ose diskriminon një person ose një grup personash për shkak të racës, kombësisë, fesë ose orientimit seksual të tyre në një mënyrë, që cenon dinjitetin njerëzor apo kush për një prej këtyre shkaqeve mohon, minimizon rëndë ose përpiqet të justifikojë gjenocid ose krime të tjera kundër njerëzimit, kush ia refuzon një shërbim, i cili ofrohet nga ana e tij dhe është dedikuar për të gjithë, një personi ose një grupi personash për shkak të racës, kombësisë, fesë ose orientimit seksual të tyre, dënohet me një dënim me heqje lirie deri në tre vjet ose me një dënim me gjobë.»

7 <https://www.admin.ch/opc/de/federal-gazette/2018/7861.pdf> (së fundmi hapur më datën 25/05/2020)